

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËR
PRANIMIN E STUDENTËVE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit së Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë (në vijim “Palët”), bien dakord për nënshkrimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

Nisur nga nevoja, vlerat, interesat e përbashkët, si dhe dëshira për të realizuar bashkëpunim produktiv të ndërsjellë, për pranimin e studentëve në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës.

Duke respektuar legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës, Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizën e Kualifikimeve të Kosovës, Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe parimet e standardet ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare.

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është bashkëpunimi institucional për lehtësimin e procedurave të pranimit të studentëve, shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, në institucionet e arsimit të lartë, në të dy vendet respektive.

Neni 2

Institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për ndjekjen e procedurave të aplikimit nga ana e kandidatëve, deri në pranimet në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë janë: institucioni arsimor parauniversitar i përcaktuar nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, për pasqyrimin e notave të kandidatëve, Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) për njehsimin e notave të kandidatëve dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), për administrimin e aplikimeve deri në regjistrimin e kandidatëve.

Institucioni përgjegjës për ndjekjen e procedurave të aplikimit nga ana e kandidatëve, deri në pranimet në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës është Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës, nëpërmjet NARIC Kosova (Qendra kombëtare për njohje të diplomave) për njohje dhe barasvlerë të diplomës/dëftesave të shkollës së mesme dhe për barasvlerësimin e notave/suksesit nga shkollimi i mesëm dhe provimi i maturës, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë për administrimin e aplikimeve dhe regjistrimin e kandidatëve.

Neni 3

Bashkëpunimi institucional

1. Bashkëpunimi institucional për pranimin e studentëve në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, do të realizohet me anë të:
 - a. Bashkëpunimit në lehtësimin e procedurave të njohjes së diplomave të arsimit të mesëm të lartë, të fituara në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës, për pranimin e studentëve në institucionet e arsimit të lartë.
 - b. Unifikimit të procedurave për aplikimin dhe regjistrimin në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të kandidatëve shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës në institucionet e arsimit të lartë, në të dy vendet respektive.

2. Kandidatët shtetas të Republikës së Shqipërisë për aplikimin dhe regjistrimin në programet e përcaktuara në germën “b” të këtij neni, duhet të plotësojnë të njëjtat kritere dhe të ndjekin të njëjtat procedura, sikurse dhe shtetasit e Republikës së Kosovës.
3. Kandidatët shtetas të Republikës së Kosovës për aplikimin dhe regjistrimin në programet e përcaktuara në germën “b” të këtij neni, duhet të plotësojnë të njëjtat kritere dhe të ndjekin të njëjtat procedura, sikurse dhe shtetasit e Republikës së Shqipërisë, përfshirë dhe plotësimin e kriterit të notës mesatare për pranimin në këto programe studimi.

Neni 4

Lehtësimi i procedurave

1. Për diplomat e arsimit të mesëm të lartë, njohja në të dy vendet, për efekt pranimi në institucionet e arsimit të lartë, kryhet brenda afatit prej 3 (tre) ditë pune.
2. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, kanë të drejtë të vazhdojnë studimet e larta në vendet respektive, sipas të njëjtave rregulla dhe procedura që i përkasin vendit respektiv për shtetasit e atij vendi, përfshirë dhe notën mesatare, me përjashtim të kategorive të veçanta, për të cilat nuk aplikohet nota mesatare për pranim në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

Përcaktimi i procedurës dhe dokumentacionit për aplikimet në institucionet e arsimit të lartë

1. Shtetasit e Republikës së Kosovës që duan të ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë duhet të:
 - a. Aplikojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), e cila kryen procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave/ diplomave së arsimit të mesëm të lartë, për vijimin e studimeve në arsimin e lartë, në rrugë postare ose dorëzojnë në QSHA, dokumentet si më poshtë:
 - i. Formularin e aplikimit për njëvlershmëri sipas legjislacionit në fuqi;
 - ii. Fotokopjen e dokumentit të identifikimit të aplikantit;
 - iii. Kopjen e njësuar me origjinalin e dëftesave të të gjitha viteve të shkollimit dhe diplomës që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë jashtë vendit, ose në mungesë të

dëftesave, kopja e përkthyer dhe e njehsuar me origjinalin e listës së notave të arsimit të mesëm të lartë;

- iv. Kopjen e njehsuar me origjinalin e dokumentit që vërteton se ka dhënë provime kombëtare të njëvlershme me ato të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Dokumentet e paraqitura për njëvlershmeri duhet të kenë vulën apostile.

b. QSHA shqyrton aplikimin dhe harton dokumentin e njëvlershmerisë, në të cilin përcaktohet:

- i. Nota mesatare e përgjithshme, e njëvlerësuar.
- ii. Notën/at e njëvlerësuar me provimet e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.
- iii. Nota mesatare e përgjithshme, e njëvlerësuar.

c. Pas njëvlershmerisë së dëftesave/ diplomave së arsimit të mesëm të lartë nga QSHA, aplikanti vijon procedurën për plotësimin e formularëve A1/A1Z tek institucioni arsimor parauniversitar i caktuar nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë. Komisioni shkollor në shkollën e autorizuar nga ZVAP Tiranë, hedh notat për të gjitha vitet e arsimit të mesëm të kryer jashtë shtetit, sipas dokumentacionit të përgatitur nga Komisioni i Posaçëm në QSHA.

d. Shtetasit e Republikës së Kosovës, për ndjekjen e studimeve në institucionet e arsimit të lartë në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, duhet të kryejnë procesin e aplikimit online në portalin e aplikimit universitar U-Albania, si dhe vijimin me procedurat e tjera, në përputhje me udhëzimin nr.10, datë 15.05.2019, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar dhe sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA dhe RASH, për çdo vit akademik.

2. Shtetasit e Republikës së Shqipërisë për ndjekjen e studimeve në institucionet e arsimit të lartë në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në Republikën e Kosovës, duhet të:

a. Aplikojnë nëpërmjet NARIC Kosova, e cila kryen procedurat e barasvlerës dhe njohjes së diplomës/dëftesave të arsimit të mesëm të lartë, për vijimin e studimeve në arsimin e lartë.

Aplikimi bëhet drejtpërdrejtë tek zyrtari kompetent në MASHTI, me dokumentet si më poshtë:

- i. Kërkesën për njohje dhe barasvlerë të dokumenteve;
- ii. Dokumentin e identifikimit;
- iii. Origjinalin e diplomës ose dëftesës në shikim për nivelin e shkollimit;
- iv. Certifikatën e maturës;

v. Diploma e paraqitura për njëvlershmëri duhet të ketë vulën apostile.

NARIC Kosova shqyrton aplikimin dhe harton vendimin për barasvlerë dhe njohje të diplomës-dëftesave, në të cilin përcaktohet:

- i. Njohja e diplomës- dëftesës;
- ii. Barasvlerësimi i diplomës;
- iii. Suksesi i përgjithshëm gjatë viteve të shkollimit dhe barasvlerësimi i notave;
- iv. Barasvlerësimi i Provimit të Maturës dhe përcaktimi se kandidati i plotëson kushtet për konkurrim në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

Kandidati, me vendimin e marrë në MASHTI, mund të aplikojë për nivelin bachelor, në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

b. Shtetasit e Republikës së Shqipërisë, për kryejnë procesin e aplikimit për regjistrim në universitetet publike të Republikës së Kosovës sipas kushteve dhe brenda afateve kohore të përcaktuara me konkursin për regjistrimin e studentëve të rinj që shpallet nga secili universitet.

Neni 6

Zbatimi i Marrëveshjes

1. Bashkëpunimi i përcaktuar me këtë Marrëveshje do të zbatohet në pajtim me legjislacionin në fuqi të të dy vendeve, si dhe sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së diplomave, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, anëtare të së cilave janë Palët.
2. Për qëllim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje krijohet një Komitet i Përbashkët i përbërë nga 3 përfaqësues të secilës palë. Komiteti i Përbashkët takohet dy herë brenda vitit ose kurdoherë që është e nevojshme, në mënyrë alternative në Tiranë dhe Prishtinë, me qëllim të shqyrtimit të çështjeve me interes për zbatimin e Marrëveshjes.

Neni 7

Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare dhe rinovohet automatikisht për periudhën pasuese pesëvjeçare, nëse asnjëra prej Palëve nuk e njofton Palën tjetër, me shkrim, për ndërprerjen e saj, të paktën gjashtë muaj para afatit të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Tarifat e studimit

Studentët nga Republika e Shqipërisë paguajnë të njëjtat tarifa si dhe studentët nga Republika e Kosovës në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, studentët nga Republika e Kosovës paguajnë të njëjtat tarifa si dhe studentët nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 9

Ndryshimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të palëve.

Neni 10

Dispozita të fundit

Kjo marrëveshje nuk ndryshon procedurat ligjore të miratuara nga Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës për kuotat e veçanta të miratuara për vendet respektive.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj.

Nënshkruar në PRISHTINË, më 20.06.2022, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës,
Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës
së Kosovës

301

Znj. Arbërie NAGAVCI

Për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit
të Republikës së Shqipërisë

Znj. Evis KUSHI